Informator për Qytetarë

Buxheti i Republikës së Kosovës – 2021



- *Çka është buxheti*
- *Procesi i përgatitjes së Buxhetit*
- *Si do të mbushet buxheti i Kosovës*
- *Financimi i komunave për kokë banori*
- *Ku do të shpenzohen paratë e buxhetit të Kosovës*
- *Investimet më të mëdha kapitale dhe financimet e tjera*
- *Buxheti Qendror, Buxheti Komunal, Deficiti dhe Huamarrja*

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës

Të nderuar lexues

Duke e pasur parasysh rëndësinë e komunikimit me qytetarët për udhëheqjen e financave publike, është kënaqësi të ju prezantojmë Informatorin për Qytetarë për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Meqenëse pjesa më e madhe e të hyrave buxhetore mblidhet përmes tatimeve, obligim i yni është që qytetarëve të Republikës së Kosovës në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme të ju ofrojmë informatat lidhur me mbledhjen e të hyrave dhe ekzekutimin e shpenzimeve. Prioritet i Ministrisë së Financave në procesin e planifikimit të buxhetit është konsolidimi fiskal përmes harmonizimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Mirëpo, për shkak të situatës së krijuar pandemike, është shtruar nevoja e rishikimit të kufijve buxhetor 2021-2023 gjate përgatitjes se projektbuxhetit per vitin 2021. Me këtë rast është dashur të merren për bazë dhe të adresohen çështjet e financimit të Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike në vend.

Ministria e Financave parasheh që në vitin 2021 ekonomia e Kosovës pritet të rritet me një normë reale mbi trendin e vet historik, rreth 5.2 % duke ju rikthyer nivelit te ngjashëm te regjistruar para krizës COVID-19. Megjithatë, parashikimet janë të rrethuara me pasiguri të lartë. Skenari bazë varet ndjeshëm nga faktorët lidhur me shëndetin dhe faktorët e tjerë ekonomik që në ketë periudhë është vështirë për t'u parashikuar. Kontributi kryesor në rritjen ekonomike pritet të vije kryesisht nga eksporti total veçanërisht ai i shërbimeve për t'u ndjekur nga investimet private. Gjatë vitit 2021 pritet një dinamike me e shpejtë e ekzekutimit të investimeve kapitale. Projeksionet mbi të hyrat buxhetore tregojnë se ne vitin 2021 të hyrat totale do të jene në shume prej 1 miliard e 888 milion EUR. Këto projeksione te të hyrave marrin parasysh pritjet për ecurinë ekonomike por edhe efektin e politikave të ndryshme tatimore që kemi ndërmarrë gjatë këtij vitit 2020 dhe efektet e marrëveshjeve për tregtinë e lire. Gjithsej shpenzimet buxhetore janë planifikuar të jenë në shumë prej 2 miliard e 452.2 milion EUR. Viti 2021 karakterizohet me një rënie në disa prej kategorive të shpenzimeve kryesisht për shkak të efektit bazë të vitit 2020 kur ka pasur një rritje të theksuar në disa kategori si rrjedhoje e masave stimuluese fiskale të qeverise të cilat planifikohen të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2021 por me një shkallë me të ulët. Si rrjedhoje e financimit të shtuar per shpenzimet rrjedhëse për të akomoduar nevojat socio ekonomike si pasoje e pandemisë, deficiti i përgjithshëm buxhetor për vitin 2021 pritet të jetë 337.3 milion EUR, apo 4.7 e BPV-së, për të vazhduar me një ritëm zvogëlimi ne 2.4% në vitin 2022 dhe 1.8% në vitin 2023. Deficiti i parashikuar buxhetor pritet të financohet nga bilanci i akumuluar bankar i Qeverisë, nga borxhi i brendshëm, nga huamarrja e jashtme nga institucionet financiare ndërkombëtare si dhe nga fondet e likuidimit (AKP).

Hekuran Murati,

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Çka është buxheti?

Çdo individ apo familje, i planifikon shpenzimet në bazë të mjeteve që ka në dispozicion, apo një familje e llogarit koston e jetesës së saj sipas një buxheti – të hyrat që ka dhe të cilat mund t'i shpenzojë për gjërat elementare sikurse janë të ushqyerit, veshmbathja, pagesa për qira, shpenzime komunale, argëtimi, rekreacioni, etj.

Në të njëjtën mënyrë, edhe Qeveria i planifikon shpenzimet e saj në varësi të buxhetit që harton dhe ka në dispozicion. Ajo planifikon se sa nga të hyrat e saj do të shpenzohen për nevoja të ndryshme të shtetit si për shembull, për pagat e të punësuarve në sektorin publik, për shpenzime operative të institucioneve publike, shpenzime për arsim, shëndetësi, pensione, nxitje të punësimit dhe zbutje të varfërisë, shpenzime kapitale, rritjen e mirëqenies së qytetarëve, zhvillimin e ekonomisë, etj. Ndryshe nga buxheti i individit- familjes, buxheti i shtetit planifikohet për një periudhë të caktuar që quhet "vit buxhetor". Ky vit përbëhet nga 12 muaj dhe sipas standardeve të vendosura në vendin tonë është i njëjtë me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor

Buxheti është një plan i të hyrave dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohore që zakonisht është një vit.
Buxheti hartohet dhe rivlerësohet poashtu në baza periodike. Buxheti i Republikës së Kosovës paraqet dokumentin në formë të ligjit me të cilin planifikohen tëhyrat dhe shpenzimet e shtetit për tërë vitin kalendarik. Buxheti i Kosovës përgatitet nga Ministria e Financave (MF), në koordinim me organizatat buxhetore, dhe miratohet në fund të vitit nga Kuvendi i Kosovës.
Buxheti për vitin e ardhshëm përgatitet gjatë vitit Në kohën kur Kuvendi miraton ndarjet buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal, këto ndarje buxhetore bëhen ligj i cili quhet Ligji për Buxhetin për atë vit të caktuar. Ky ligj i buxhetit i miratuar nga Kuvendi u ofron organizatave buxhetore autorizim për të shpenzuar apo transferuar fonde publike, deri në ku jtë e caktuar dhe për qëllimet e caktuara sipas ligjit, gjatë një viti të caktuar fiskal.

Bruto Produkti Vendor (BPV)

Bruto Produkti Vendor 2020 (me rishikim projektim)

7,160 milionë €

Bruto Produkti Vendor në krahasim me 2020

është 3 % me lartë në vitin 2021

Trendi i rritjes së BPV-së nga viti 2018 dhe projektimi për vitet në vijim



Procesi i përgatitjes së Buxhetit

30 Prill

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

Qeveria do t'ia dorëzojë Kuvendit të Kosovës Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) që mbulon vitin e ardhshëm fiskal dhe bën përllogaritjen për dy vitet e ardhshme fiskale.

15 Maj

Qarkoret Buxhetore

Afati kur MF-ja e dorëzon qarkoren e parë buxhetore tek organizatat buxhetore. Brenda qarkoreve nxirren kufijtë buxhetor për çdo organizatë buxhetore.

15 Qershor - 31 Tetor

Propozimet Buxhetore

Gjatë periudhës korrik-gusht, MF-ja i shqyrton propozimet dhe organizon ndëgjime buxhetore me organizatat buxhetore. Jo më vonë se më 31 tetor, MF-ja përgatit propozimin me ndarjet buxhetore për secilën organizatë buxhetore dhe Qeveria aprovon atë.

30 Shtator

Afati p r propozimin e buxhetit

Data deri kur komunat duhet të përfundojnë dhe dorëzojnë propozimet e tyre të buxhetit dhe kërkesat për ndarje buxhetore tek MF-ja. Për organizatat buxhetore përveç komunave, afati për dorëzimin e dokumenteve të tilla do të përcaktohet në qarkoren buxhetore.

Pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjimet buxhetore nëpër komuna

Çdo komunë është e obliguar t'i njoftoj qytetarët e saj për orarin e dëgjimeve buxhetore, ku ata mund të marrin pjesë.

Pjesmëmarrja e qytetarëve në procesin e shqyrtimit të Buxhetit në Kuvend



Maj - Qershor

Rishikimi gjysmë-vjetor i buxhetit aktual

Qeveria mund të bëjë rishikimin e buxhetit.

31 Gusht

Auditimi

Më 31 gusht, Auditori i Përgjithshëm dorëzon në Kuvend Raportin Vjetor të Auditimit për vitin paraprak, të cilin Kuvendi e shqyrton dhe miraton së bashku me deklaratat financiare të Qeverisë jo më vonë se më 31 tetor.

31 Tetor

Kuvendi

Qeveria miraton Buxhetin e propozuar dhe e dërgon atë në Kuvend.

31 Dhjetor

Buxheti i Kosovës

Afati i fundit kur Kuvendi miraton Buxhetin e Kosovës.

Çka nëse nuk miratohet Ligji për Ndarjet Buxhetore para fillimit të vitit përkatës fiskal?

Nëse një Ligj për Ndarjet Buxhetore për një vit të caktuar fiskal nuk miratohet nga Kuvendi dhe nuk shpallet në mënyrë të rregullt nga personi i autorizuar për këtë shpallje para fillimit të vitit përkatës fiskal, ligji mbi ndarjet buxhetore i cili ka qenë në fuqi vitin e mëparshëm mund të zgjatet me autorizim dhe vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në asnjë rast ligji i vitit të kaluar fiskal nuk mund të zgjatet për më shume se tre (3) muaj të vitit të ardhshëm fiskal.

Si do të mbushet buxheti i Kosovës në vitin 2021?

Të hyrat e përgjithshme për vitin 2021 pritet të arrijnë shumën prej 1,888 milionë Euro. Kjo shumë paraqet një rrtije prej 6% apo 99 milionë EUR më shumë se në vitin 2020. Nëse e shikojmë pjesëmarrjen e tatimeve në totalin e të hyrave, atëherë tatimet indirekte përbëjnë 75 % të të gjitha të hyrave, tatimet direkte përbëjnë 16 % në totalin e të hyrave buxhetore. Të hyrat jotatimore përbëjnë 10.5 % të totalit të të hyrave, grantet 1.19%.

Sa i përket Administratës Tatimore të Kosovës, ajo pritet që në vitin 2021 të arkëtojë rreth 520 milionë EUR, duke i përfshirë të hyrat e njëhershme nga arkëtimi i borxhit tatimor. Kjo normë shënon një rritje prej 4 % në raport me vitin 2020 , derisa Dogana e Kosovës pritet të arkëtojë -8.2% më shumë në raport me vitin 2020. e që pritet të arkëtohen në vlerën prej 1,173 milionë EUR për vitin 2021.

Tatimet indirekte

Tatimet direkte

Të hyrat jo-tatimore

Grante për mbështetje buxhetore



Të hyrat e Buxhetit të Kosovës

ZBËRTHYER

Burimet e financimit të Komunave

€/KOKË BANORI	BANORË	KOMUNA	BURIMET E FINANCIMIT	TOTAL FINANCIMI 2021
248	40,019	*Deçan*		9,942,300 €
261	33,997	*Dragash*		8,856,615 €
315	108,610	*Ferizaj*		34,208,507 €
316	34,827	*Fushë Kosovë*		10,992,685 €
278	94,556	*Gjakovë*		26,330,580 €
308	90,178	*Gjilan*		27,734,737 €
263	58,531	*Gllogoc*		15,399,334 €
268	9,403	*Hani i Elezit*		2,520,166 €
324	39,289	*Istog*		12,749,113 €
254	6,084	*Junik*		1,546,703 €
263	33,409	*Kaçanik*		8,782,599 €
297	36,085	*Kamenicë*		10,725,420 €
277	38,496	*Klinë*		10,658,263 €
313	13,773	*Leposaviq*		4,313,184 €
290	57,605	*Lipjan*		16,719,155 €
273	54,613	*Malishevë*		14,900,757 €
310	5,507	*Mamushë*		1,706,403 €
288	71,909	*Mitrovicë*		20,725,819 €
417	6,729	*Novo Bërdë*		2,808,423 €
519	21,549	*Obiliq*		11,190,796 €
284	96,450	*Pejë*		27,410,165 €
270	88,499	*Podujevë*		23,853,654 €
431	198,897	*Prishtinë*		85,792,836 €
269	177,781	*Prizren*		47,788,686 €
253	56,208	*Rahovec*		14,216,590 €
524	6,949	*Shtërpcë*		3,643,263 €
304	27,324	*Shtime*		8,309,317 €
279	50,858	*Skenderaj*		14,207,589 €
274	59,722	*Suharekë*		16,334,504 €
266	46,987	*Viti*		12,490,686 €
270	69,870	*Vushtrri*		18,878,129 €
350	6,616	*Zubin Potok*		2,313,745 €
296	7,481	*Zveçan*		2,217,443 €
734	10,675	*Gracanicë*		7,839,373 €
424	2,556	*Kllokot*		1,084,567 €
405	12,326	*Mitrovica veriore*		4,996,273 €
594	1,787	*Partesh*		1,060,716 €
401	3,866	*Ranillug*		1,552,183 €
				546,801,278.9 €

Grantet

Granti i Përgjithshëm

Granti i Përgjithshëm kalkulohet duke marr për bazë të hyrat e për ithshëm të Buxhetit të Kosovës, ku 10% e të hyrave totale ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.
Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të për ithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të për ithshëm në komuna sipas LFPL:
numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%);
përmasat gjeografike të komunës me ashtë përqind (6%);
numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%);
komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Granti specifik për Arsim parauniversitar

Granti Specifik për Arsim sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHT.
Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:
Numri i nxënësve të re istruar;
Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013 të MASHT);
Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2; Kalkulimi për stafin mësimdhënës të uhës angleze për klasën I dhe II;
Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin para fillor dhe fillor;
Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
Kalkulimi për stafin mësimdhënës në lehoni është paraparë 3% (bazë stafi mësimdhënës);
Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë para fillorë dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës dhe Politika te reja dhe ne vazhdimësi te cilat aprovohen nga Komisioni i Granteve çdo vit.

Granti specifik për Shëndetësi primare

Granti specifik për shëndetësi primare përgatitet sipas kriterit për kokë banori dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Granteve

Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale

Në këto projeksione janë marr parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme (tatimi në tokë dhe tatimi në pronë) sipas faturimit të tatimit në pronë dhe trendit të realizimit të të hyrave jo tatimore atë tri viteve të fundit, duke përjashtuar nga këto projeksione të hyrat nga gjobat në trafik dhe të hyrat nga g ykatat.

Në total financimin e komunve përfshihet edhe klauzola e Investimeve për komuna shumë prej euro në shumë prej 7.3 milion.

Ku do të shpenzohen paratë e buxhetit të Kosovës në vitin 2021?

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021planifikohen të jenë 2,454 milionë EUR për 166 milionë EUR (apo 6%) më pak krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2020, qe do të reflektojnë në fushat me prioritet nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Programi për Reforma në Ekonomi 2020- 2022, si dhe në Programn për Rimëkëmbje në shumë prej 222 Mil Euro.

Buxheti Komunal – 547 milion EUR
Krahasuar me Buxhetin e Rishikuar për vitin 2020 shpenzimet në nivelin komunal janë projektuar të shënojnë rënie për 34.7 milionë euro, apo me rreth 6%. Gjatë vitit 2021 pritet rritje në kategorinë e pagave dhe shtesave me 0.7 milionë; rritje të shpenzimeve për mallra dhe shërbimeve me 1.4 milionë; rënie në kategoritë e shpenzimeve kapitale për 4.1 milionë Euro; dhe rënie ne shpenzimet për subvencione dhe transfere prej 3.4 milionë Euro. Në vitet 2022 dhe 2023 shpenzimet e nivelit lokal parashihet të rriten.
Buxheti Qendror – 1,869 milion EUR
Buxheti i planifikuar për nivelin qendror për vitin 2021 parashihet të kenë rënie prej 1.5%, krahasuar me shpenzimet e planifikuara në Buxhetin e Rishikuar për nivelin qendror për vitin 2020. Kjo rënie i atribuohet kryesisht planifikimit për shpenzime për kategorinë e subvencioneve
dhe transfereve, ku për vitin 2021 në nivelin qëndror janë planifikuar 737.2 milionë euro apo rënie prej 4.0%. Gjithashtu, është planifikuar të ketë rënie në shpenzimet për mallra dhe shërbime për 5.6%.
Ndërsa, për disa kategori është planifikuar të ketë rritje: shpenzimet për paga dhe shtesa me rreth 1.5% dhe shpenzimet kapitale me rritje prej 0.7%.

Shpenzimet buxhetore të Kosovës 2021

2,454 milion EUR

6% apo 166 milion EUR më pak krahasuar me 2020

Struktura e Shpenzimeve



Investimet më të mëdha kapitale nga buxheti i shtetit për vitin 2021 dhe financimet e tjera

Infrastrukturë		
Zgjerimi i rrugës Dollc-Gjakovë	*3 vit*	1.6 milionë
Ndërtimi i rrugës Prishtinë – Podujevë	*1 vit*	3.0 milionë
Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës Prishtinë – Mitrovice	*3 vit*	25.8 milionë
Rruga nacionale Prishtinë - Gjilan – Konqul	*3 vit*	45.4 milionë
Zgjerimi i rrugës Komoran, Drenas, Skenderaj	*3 vit*	9.0 milionë
Zgjerimi i pistës dhe ngritja e sistemit të aterrimit		
në Aeroportin "Adem Jashari"	*1 vit*	14.5 milionë
Zhvillimi Ekonomik		
Ekonomia digjitale në Kosovë	*1 vit*	3.2 milionë
Ndërtimi i Zonave Ekonomike nëpër Kosovë	*3 vite*	8.7 milionë
Pushteti Lokal		
Bashkëfinancim me donatorë për skemën e granteve të bazuar në performance	*1 vit*	2.3 milionë
Mjedisi		
Projekti për ujë dhe kanalizim për zonat rurale të Kosovës	*1 vit*	2.2 milionë
Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza në Komunën e Prishtinës	*1 vit*	3.0 milionë
Mbrojtja		
Autoblinda	*1 vit*	6.2 milionë
Automjete Transporti	*3 vite*	21.8 milionë
Armatim i lehtë sipas PSO	*1 vit*	4.9 milionë
Sistemi i armatimit	*1 vit*	4.2 milionë

Gjatë vitit 2021 shpenzimet kapitale do të arrijnë shumën 626 milionë euro, ndërsa investimet për infrastrukturën rrugore do të vazhdojnë të mbizotërojnë kategorinë e shpenzimeve kapitale, si vazhdimësi e projekteve të filluara në vitet e kaluara. Ngritje graduale të investimeve kapitale do te ketë edhe në sektorët e tjerë duke marre për baze prioritet qeveritare në periudhën afatmesme.

Arsim		
Gjuha shqipe dhe kompjuteri	*1 vit*	1.0 milionë
Reforma në arsim	*1 vit*	2.1 milionë
Sport		
Stadiumi nacional i futbollit	*3 vite*	2.5 milionë
Renovimi i stadiumit e qytetit në Gjilan	*3 vite*	4.6 milionë
Shëndetësisë		
Participimi i Ministrisë së Shëndetësisë në projekte	*1 vit*	18.7 milionë
Ndërtimi i objektit të spitalit në Ferizaj	*1 vit*	2.5 milionë
Pajisje mjekësore	*3 vite*	11.6 milionë
Modernizimi i infrastrukturës të objekteve spitalore	*3 vite*	6.2 milionë
Komunitete dhe Kthim		
Projekti për komunitete	*3 vite*	8.3 milionë
Projekti për kthim ndërtimi i shtëpive për të kthyerit	*3 vite*	6.5 milionë

Skemat pensionale dhe të mirëqenies sociale

Aktualisht, vetëm nga Skema e asistencës sociale përfitojnë mbi 26,000 familje, me mbi 106,000 anëtarë

Transferet Sociale

Zbatimi i Li it-V.DH.S.	1,200,000	€
Pensionet bazike sociale	147,000,000	€
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara	17,650,000	€
Pensionet e parakohshme-Trepça	4,200,000	€
Pensionet e parakohshme- TMK	3,000,000	€
Pens. kontributdh. +pens.arsimit vit.90	122,648,000	€
Pensionet e pjesëtarëve të FSK	2,400,000	€
Provizionet bankare	1,800,000	€
Kompenzimi për të burgosurit politikë	5,500,000	€
Kompenzimi për të verbërit	5,400,000	€
Pensioni familjar	4,000,000	€
Pensioni invalidor i punës	115,000	€
Pensioni për përsonat paraplegjik dhe tetraplegjik	11,000,000	€
Ndihmat sociale	31,000,000	€
Shërbimet sociale	3,000,000	€
Shpenzimet bazike për strehimoret	1,000,000	€
Pagesa për komunali për raste sociale	4,500,000	€
KPSHSF	100,000	€
Shërbimet e punësimit	7,800,000	€
Shërbimet e aftësimit profesional	200,000	€
Financimi i deputetëve të viteve 90-ta	287,000	€
Pensionet për invalidët e luftës	39,800,000	€
Pensionet për veteranët	75,000,000	€
Totali	**488,600,000**	**€**

Buxheti Qendror

Si përqindje e 1,869 milion



27.38% Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

11.86% Ministria e Infrastrukturës

7.61% Ministria e Punëve të Brendshme

5.58% Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

5.20% Ministria e Shëndetësisë

3.28% Ministria e Bujqësisë, Pyllitarisë dhe Zhvillimit Rural

3.43% Ministria e Arsimit dhe Shkencës

3.60% Ministria e Mbrojtjes

3.33% Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

1.87% Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

11.07% Ministria e Financave

2.13% Universiteti i Prishtinës

1.61% Ministria e Punëve të Jashtme dhe Dijasporës

1.62% Agjencitë tjera të pavarura*

1.44% Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

1.56% Këshilli Gjyqësor i Kosovës

2.08% Ministria e Drejtësisë

0.77% Prokurori i Shtetit

0.68% Zyra e Kryeministrit

0.71% Organizatat buxhetore te financuara nga të hyrat e dedikuara

Agjensioni për Shërbimet e Navigimit Ajror
Agjencia Kosovare e Privatizimit

0.58% Kuvendi i Kosovës

0.60% Radio Televizioni i Kosovës

0.48% Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

0.29% Ministria për Komunitete dhe Kthim

0.51% Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

0.35% Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

0.25% Ministria e Pushtetit Lokal

0.20% Shpenzimet e Paparashikuara

0.15% Ministria e Zhvillimit Rajonal

0.17% Zyra e Presidentit


546.801,286 €
Buxheti i komunave për vitin 2021
Paga dhe mëditje
Mallra dhe shërbime
Shpenzimekomunale
Subvencione dhe transfere
Shpenzime kapitale
Kllokot 0.20%
Partesh 0.19%
Junik 0.28%
Ranillug 0.28%
Mamusha 0.31%
Zveçan 0.41%
Zubin Potok 0.42%
NovoBërdë 0.51%
Hani I Elezit 0.46%
Shtërpcë 0.67%
Leposaviq 0.79%
Mitrovica e Veriut 1.91%
Kaçanik 1.61%
Dragash 1.62%
Deçan 1.82 %
Kamenicë 1.96%
Shtime 1.52%
Klinë 1.95%
Fushë Kosovë 2.01%
Viti 2.28%
Obiliq 2.05%
Graçanicë 2.43%
15..69% Prishtinë
8.74% Prizren
6.25% Ferizaj
4.36% Podujevë
5.01% Pejë
5.07% Gjilan
4.82% Gjakovë
3.79% Mitrovicë
3.46% Vushtrri
2.99% Suharekë
3.06% Lipjan
2.33% Istog
2.82% Gllogoc
2.73% Malishevë
2.60% Rahovec
2.60% Skenderaj

Deficiti i Kosovës

Si rrjedhojë e rritjes së financimit të shtuar për shpenzimet rrjedhëse si nevojë për të akomoduar nevojat socio-ekonomike si pasojë e pandemisë, deficiti i pritshëm buxhetor për vitin 2021 pritet të jetë 337.3 milionë EUR, apo 4.7% e BPVsë, për të vazhduar me një ritëm zvogëlimi në 2.4% (apo 180.5 milionë EUR) në vitin 2022, si dhe 1.8% (apo 141.7 milion EUR) atë vitit 2023. Duke aplikuar rregullën fiskale nga viti 2014 e tutje është kufizuar deficiti buxhetor në shpenzime publike në kufirin deri në 2% të BPV-së.

Mirëpo, atë vitit 2020 Qeveria e Kosovës ka marr vendim për tejkalimin e përkohshëm të kufirit të deficitit deri në 6.5% të BPV-së.
Ngjashëm me vitet e kaluara, deficiti i parashikuar buxhetor pritet të financohet nga bilanci i akumuluar bankar i Qeverisë, nga borxhi i brendshëm, nga huamarrja e jashtme nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe nga fondet e likuidimit (AKP).

Huamarrja

Shteti merr hua nga institucionet financiare ndërkombëtare, siç janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (Banka Botërore), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës (BZhKE) si dhe nga kreditorë tjerë multilateral e bilateral, i cili quhet borxh ndërkombëtar

Deri në fund të vitit 2020, stoku i borxhit ndërkombëtar ka arritur vlerën në 525.80 milionë euro ose 7.55% e BPV-së. Ndërsa borxhi i brendshëm, deri në fund të vitit 2020, ka arritur vlerën në 961.90 milionë euro ose 13.82% e BPV-së.

Borxhi ndërkombëtar sipas kreditorëve 2020:



Trendi i borxhit gjatë viteve



Stoku i borxhit të përgjithshëm:



Fjalori dhe përkufizimet e Menaxhimit të Financave Publike

Financat publike - paraqesin aktivitetin shtetëror në lidhje me mbledhjen e parasë publike ose të hyrave publike, nga një anë dhe me realizimin e shpenzimeve publike nga ana tjetër. Në kuptimin më të gjërë ato studiojnë rolin e Qeverisë në ekonomi
Buxheti - plani gjithëpërfshirës i të ardhurave dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar - zakonisht një vit.

Bruto produkti vendor - është një indikator ekonomik që paraqet vlerën nominale të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një periudhe (zakonisht një viti) në një ekonomi të një shteti.

Qarkorja(et) buxhetore - dokumente ku shtjellohen politikat e MF-së në lidhje me aspekte të ndryshme të procesit buxhetor, informatat të cilat i nevojiten organizatave buxhetore për pjesëmarrje në procesin buxhetor, kërkesat fiskale procedurale të cilat duhet të ndiqen nga ato dhe formularët e udhëzimet e hollësishme për kryerjen e tyre.
Rishikimi i buxhetit - ndryshimi i Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, zakonisht në gjysmë vjetorin e dytë.
Kufijtë buxhetorë - janë kufij brenda të cilëve një Organizatë Buxhetore duhet të përgatisë buxhetin e saj

Organizatë buxhetore - do të thotë një autoritet ose ndërmarrje publike e cila drejtpërdrejtë pranon një ndarje buxhetore sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, ndarje buxhetore kjo që nuk është pjesë e një ndarje tjetër të përgjithshme buxhetore e cila i është bërë një autoriteti ose ndërmarrje tjetër publike.

Deficiti buxhetor - shuma me të cilën shpenzimet shtetërore tejkalojnë të ardhurat shtetërore në një vit

Suficiti buxhetor - shuma me të cilën të ardhurat shtetërore tejkalojnë shpenzimet shtetërore në një vit

Politikat publike - politikat publike janë aktivitetet e Qeverisë dhe të autoriteteve publike, me qëllim për të arritur objektivat ekonomike dhe sociale të cilat janë në interesin më të mirë të shoqërisë. Disa nga shembujt e fushave të politikave publike, janë arsimi, shëndetësia, papunësia mbrojtja etj
Korniza Afatmesme e Shpenzimeve KASH - është një dokument i prioriteteve të politikave të qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërinë në procesin e buxhetit duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm makroekonomik dhe fiskal (zakonisht në një periudhë 3 vjeçare).

Të ardhurat publike - të gjitha të ardhurat e krijuara nga pagesat e detyrueshme të tatimpaguesve, personave juridik dhe fizik që përdorin të mirat e caktuara publike ose shërbimin publik, si dhe të gjitha të ardhurat tjera të realizuara nga përfituesit e buxhetit.
Të ardhurat nga privatizimi - nënkupton të gjitha të ardhurat që mund të vijnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës si rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve në pronësi publike dhe/apo të ardhurat nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, duke mos përfshirë të hyrat e dedikuara të AKP-së
Akciza - taksë për konsum, e cila llogaritet (aplikohet) për mallrat e caktuara si psh: duhani, veturat, karburantet, pijet alkoolike, ka a etj.

Tatimi - është detyrim shtetëror të cilit i nënshtrohen personat dhe mallrat sipas përkufizimeve në ligjet administrative të shtetit. Shteti mbledhpagesat nga tatimpaguesit në emër të tatimit në pronë, të shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe për të ardhurat dhe pasurinë e personave fizik dhe kompanive.

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) - është një tatim mbi konsumin për mallra dhe shërbime në të gjitha fazat e prodhimit dhe shitjes, duke filluar nga lënda e parë deri të produkti përfundimtar. TVSH- ja është tatimi kryesor në Kosovë.
Taksa - është kontribut i detyrueshëm për tu paguar nga çdo person i cili drejtpërdrejtë përfiton një shërbim publik.
Të ardhurat jo-tatimore - lloji i të hyrave publike që mblidhen nga personat juridik apo fizik për përdorimin e të mirave publike (tarifat), sigurimin e shërbimeve të caktuara publike (taksat), për shkelje të dispozitave kontraktuese ose ligjore (ndëshkime dhe gjoba), si dhe të ardhurat që realizohen duke përdorur fondet publike.

Politika fiskale - paraqet vendimet apo veprimet e kryera nga autoritetet në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet publike, me qëllim të ndikimit në lëvizjet ekonomike dhe arritjen e objektivave të politikës fiskale.
Rregullat fiskale - parimet që sigurojnë qëndrueshmërinë afatmesme dhe afatgjatë dhe transparencën e financave publike të një vendi.

Konsolidimi fiskal - një seri masash me të cilat shuma e të ardhurave shtetërore dhe shpenzimeve balancohet.

Garanci shtetërore - instrument i sigurimit me të cilin Republika e Kosovës garanton përmbushjen e detyrimeve për të cilat jepet garanci. Donacionet (dhurim) - të ardhurat e qëllimshme (të caktuara) të pakthyeshme, të cilat realizohen në bazë të një kontrate me shkrim ndërmjet ofruesve dhe pranuesve të donacioneve;

Dividenta - është pagesa e rregullt që një kompani u bën pronarëve nga fitimet e kompanisë.

Ndihma financiare e Bashkimit Evropian - fondet e Bashkimit Evropian të cilat përdoren për qëllime dhe zbatohen sipas rregullave të përcaktuara në marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Klauzola e investimeve - instrument që i mundëson Qeverisë të financoj projekte kapitale me interes të gjerë publik, mbi deficitin prej 2% të BPV, me kusht që këto projekte financohen nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe Agjencitë Zhvillimore.

Kategoritë e shpenzimeve - kategoritë "Pagat dhe Mëditjet", "Mallrat dhe Shërbimet", "Shërbimet Komunale", "Subvencionet dhe Transferet", "Shpenzimet Kapitale" dhe

Subvencionet - fondet e siguruara nga shteti për të ndihmuar kompanitë, personat fizik ose sektorët e veçantë të ekonomisë p.sh. bujqësia.

Shpenzimet kapitale - do të thotë pagesat për blerje të aseteve kapitale fikse, stoqeve strategjike apo emergjente, të tokës apo aseteve të paprekshme, apo pagesat e pakthyera që i lejojnë marrësit blerjen e atyre aseteve, për kompensim të marrësit për dëmtim apo shkatërrim të aseteve kapitale, apo për rritje të kapitalit financiar të marrësit.
Investimet bazuar në klauzolën për investime - shpenzimet kapitale të specifikuara për qëllimet e klauzolës së investimeve; shpenzimet për projektet kapitale të financuara nga jashtë, nga institucionet financiare mbi kombëtare, Bashkimi Evropian apo institucionet e saj, ose qeveritë e huaja apo agjencitë e tyre të zhvillimit. Auditimi - ekzaminimi zyrtar i llogarive financiare të personave fizik, personave juridikë ose të shtetit. Llogaridhënia - aftësia për të shpjeguar dhe arsyetuar zgjedhjet dhe aktivitetet, si dhe një përshkrim të asaj që ka ndodhur.
Llogaridhënia e Qeverisë ndaj qytetarëve është një
Transparenca - transparenca do të thotë "Ndarja e informacionit dhe veprimi në mënyrë të hapur." Transparenca dhe llogaridhënia së bashku formojnë parimet themelore të qeverisjes së mirë.

Ky publikim është i

Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-
Departamenti i Buxhetit

Kontakti:
Remzi Sylejmani
remzi.sylejmani@rks-gov.net
+381 (0) 38 200 34 237

Ky informator mund të gjindet në formë elektronike në:
mf.rks-gov.net

Ministria e Financave,
E
Punës dhe Transfereve